

Çfarë duhet të dinë njujorkezët rreth vaksinave të COVID-19

Vaksinat e COVID-19 tani janë të disponueshme për të gjithë njujorkezët nga moshë 16 vjeç e lart.



Vaksinat e COVID-19 janë të sigurta dhe efektive. Vaksinat kanë kaluar në shumë studime klinike që kanë treguar se janë shumë efektive në mbrojtjen e personave ndaj sëmundjes së rëndë me COVID-19, shtrimit në spital dhe vdekjes.



Vaksinat kundër COVID-19 ju jepen pa pagesë. Nuk nevojiten sigurime ose të jepni statusin e imigrimit.



Gjeni një qendër për t'u vaksinuar. Vizitoni faqen nyc.gov/vaccinefinder ose telefononi në numrin 877-829-4692 për të gjetur një qendër vaksinimi.



Mund të përjetoni efekte anësore. Efektet e zakonshme anësore përfshijnë dhimbje të krahut, dhimbje koke, dhimbje trupi, lodhje dhe temperaturë.



Vazhdoni të zbatoni masat paraprake. Vaksinat ju mbrojnë, por ende jemi duke mësuar rreth mënyrës se si ndikojnë ato në përhapjen e virusit. Vazhdoni të qëndroni në shtëpi nëse jeni të sëmurë, ruani distancë 6 këmbë nga personat e tjerë, mbani siç duhet maskën për fytyrën dhe lajini duart shpesh.

4.26.21



Vizitoni faqen nyc.gov/vaccinefinder ose telefononi në numrin 877-829-4692 për të gjetur një qendër vaksinimi.

**NYC VACCINE FOR ALL:
SAFE, FREE, EASY**

NYC
Health